

14.02.2022
Ora 16:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, E. Meta, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

Z. I. Celibashi: Mirëmbërëma, fillojmë seancën publike, e cila ka në rend dite sot dy çështje. Projektvendimin “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkive: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”. Pika e dytë ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Fillojmë me këtë çështje në rendit të ditës që ka të bëjë me prodhimin e sasisë së fletëve të votimit. Pastaj vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës, ka dekretuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar në bashkinë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Në nenit 97, pika 4, të Kodit

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

Zgjedhor, ku përcaktohet që sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind. Ndërsa në nenin 99, pika 1 thuhet që KQZ dërgon në selitë e KZAZ-ve, të ndara në kuti të veçanta për çdo QV, veç të tjerash dhe numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në QV, së bashku me numrin shtesë. Komisioni Rregullator udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020 ka përcaktuar afatin dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave për numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve për çdo QV. Referuar nenit 59, pika 1 të Kodit Zgjedhor ku thuhet “Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme ose të parakohshme, jo më vonë se 5 ditë nga nxjerrja e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, hartojnë listat e zgjedhësve. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nëpërmjet shkresës nr. 234 prot., datë 26.01.2022 dërgoi të dhënat në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga përpunimi i të dhënave, rezulton se për zgjedhjet vendore për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, janë gjithsej 941 QV, me gjithsej 654.538 zgjedhës. Duke shtuar 2-përqindëshin mbi numrin e zgjedhësve, është 667.629 fletë votimi gjithësej që do të prodhohen. Bashkëlidhur keni projektvendimin si dhe listën me sasinë e fletëve të votimit që duhet për çdo qendër votimi, faleminderit!

Z. I . Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike, keni ndonjë diskutim? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Vetëm një pyetje kisha. Numëri i fletëve të votimit të miratuara për këto qendra votimi është i njëjtë me ato të miratuara në zgjedhjet e 25 prillit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

Z. Y. Merkaç: Nuk mund ta them këtë, pasi numëri i zgjedhësve ndryshon dhe fletët e votimit prodhohen në bazë të numërit të zgjedhësve. Duke qenë se nga 25 prilli deri në 6 mars si rregull duhet të shtohen personat që mbushin 18 vjeç dhe fitojnë të drejtën e votës, duhet të jetë më i madh numëri i zgjedhësve, rrjedhimisht dhe numëri i fletëve të votimit që prodhohet, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit “Sh-L”-së: Faleminderit zoti Komisioner! Kjo është veprimtari proceduriale e parashikuar dhe në statistika siç tha dhe Sekretari i Përgjithshëm, plus është e parashikuar dhe në Kodin Zgjedhor, kështu që nuk kemi asnjë kundërshtim.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë meqenëse jemi dakord me draftin e paraqitur, e miratojmë aktin pikërisht sipas draftit të propozuar nga ana e administratës.

Vendimi nr. 76

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



14.02.2022
Ora 16:40

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, E. Meta, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

Z. I . Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkive: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”.

Z. Y. Merkaj: në zbatim të nenit 96, pika 2 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, organizon në seancë publike hedhjen e shortit ndërmjet partive politike, për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave. Neni 95, pika 2 parashikon rrethin e subjekteve politike që mund të propozojnë anëtarin e tretë e të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave bazuar në parimin shumicë parlamentare dhe opozitë parlamentare. Grupet

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

e Numërimit të Votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive. Neni 96, pika 1, parashikon kushtet ligjore që duhet të përmbushin partitë të cilat mund të propozojnë anëtarin e 3 dhe 4 të GNV-së. Sipas këtij neni, këtë të drejtë e gëzojnë partitë parlamentare të cilat janë regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021. Me shkresën nr. 259/1 prot. datë 24.01.2022, Kuvendi i Shqipërisë ka përcjellë pranë KQZ-së informacionin se në Kuvend konfigurimi i partive politike parlamentare për secilën parti është si më poshtë:
Shumica parlamentare: Partia Socialiste e Shqipërisë.

Pakica parlamentare: Partia Demokratike e Shqipërisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Socialdemokrate.

Nga sa analizohet më lart, partitë politike që kanë të drejtën për të propozuar kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-ve, respektivisht Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, nuk renditen në listën e partive që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve. Parti politike që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së, janë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Socialdemokrate. Partia Socialdemokrate nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022 dhe rrjedhimisht nuk legjitimohet të propozojë anëtarin e katërt të GNV-ve. Neni 96, pika 1/1, përcakton se “Nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik. Për këto arsye, referuar nenit 2, pikat 2 dhe 3, të udhëzimit nr. 5, datë 16.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:


Nga partitë politike të shumicës parlamentare, Partia Socialiste e Shqipërisë është e vetmja parti e cila plotëson kriterin e numrit të mandateve nga partitë e shumicës parlamentare, për të propozuar anëtarin e tretë të GNV-ve.

Nga partitë politike të opozitës parlamentare, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim përmbush kriterin e numrit të mandateve dhe i lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. Në kushtet kur listat e partive të shumicës parlamentare dhe opozitës parlamentare përmbajnë një subjekt nga secila listë, anëtari i tretë dhe i katër nuk përcaktohet nëpërmjet shortit, por është përcaktuar sipas arësytimit që thashë më lart. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Në parim në lidhje me projektaktin? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Në fakt para mbledhjes, unë kam kërkuar një informacion nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me partitë politike të cilat janë regjistruar në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022 dhe kanë fituar mandat në zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Kjo për të vlerësuar në qoftë se partitë e opozitës parlamentare, ka dhe parti të tjera që përmbushin kushtin e fitimit të dy mandateve në zgjedhjet e 25 prillit dhe më pas eventualisht anëtari i tretë të përcaktohet nëpërmjet shortit. Pasi të na vihet ky

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

informacion në dispozicion, mendoj që mund të kemi një mendim më të plotë lidhur me këtë vendim.

Z. I. Celibashi: I kemi gati këto informacione?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se u konsultuam paraprakisht para se të fillonte mbledhja, dhashë porosi dhe shumë shpejt do ta kemi informacionin gati. Vendimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021...

Z. I. Celibashi: Jo, të dyja ato informacionet që kërkoi!


Z. Y. Merkaj: Kemi dhënë porosi dhe po bëhen gati.

Z. I. Celibashi: Në rregull! Përfaqësuesi i koalicionit, përpara se të marr një vendim?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit "Sh-L"-së: Tani, mua po më duket një lojë e madhe. Janë informacione publike që mund të konsultohen edhe nga qytetari e jo më nga pjesa e tyre që janë përfaqësues të subjekteve politike këtu dhe që kanë një evidencë të qartë. Kanë qenë dhe në vitin 2021 në zgjedhjet për kuvendin, tani të kërkosh diçka që e di betë, mua më duket... në vend që të avancojmë me kohën për shkak të kohës shumë të ngushtë në të cilën zhvillohen këto zgjedhje, ne po marrim kohë sikur s'kemi asgjë tjetër për të bërë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po e ndërpresim seancën dhe po rifillojmë në orën 17:15. Ndërkohë dorëzojini përfaqësuesit të Partisë Demokratike dy informacionet që u kërkuan. Mirë, shihemi pas pak, faleminderit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Rifillon seanca


Ora 17:20

Z. I. Celibashi: Mirë, rifillojmë seancën. Atëherë, fjala është për përfaqësuesit e partive politike. Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi. Vetëm një sqarim të shkurtër në respekt të punës edhe të kolegëve të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Nga ana jonë asnjë subjekt zgjedhor politik, por as nga ana ime si përfaqësues ligjor i Partisë Demokratike nuk vihet për asnjë moment në dyshim puna, saktësia dhe korrektësia e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Megjithatë mendoj që përsa kohë ne jemi palë ose pjesë e këtij procesi, jo vetëm si spektatorë, por si aktorë, është detyra jonë që t'i kontribuojmë gjithshmërisë së një procesi sa më të rregullt zgjedhor. Në mënyrë që me qëllim final, ose me synim final të garantohen për qytetarët e gjashtë bashkive, zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kjo është arsyeja pse herë pas here kërkojmë që përpara se të shprehim një opinion apo një mendim të caktuar mbi projektaktet që na paraqiten, të verifikohen, të saktësohen, të merren informacione që disponohen zyrtarisht nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rastin konkret duke qenë se shkresa e datës 24 janar e vitit 2022 të Kuvendit të Shqipërisë nuk ka detajuar se cilat janë partitë politike që kanë fituar mandat në Koalicionin Partia Demokratike e Shqipërisë - Aleanca për Ndryshim. Ne kërkuam këtë lloj informacioni për të parë në qoftë se ka eventualisht subjekte politike që janë regjistruar në zgjedhje, të cilat kanë më shumë sesa dy mandate. Nga informacioni që na u vu në dispozicion, përkatësisht vendimi nr. 408, datë 23 qershor 2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimi nr. 21, datë 13 korrik 2021, i Komisionit Rregullator, nuk rezulton që të ketë subjekte që të përmbushin këtë

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

kriter, kështu që pasi jemi njohur me gjithë këtë dokumentacion jemi dakord me projektaktin e paraqitur, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i koalicionit?


Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit "Sh-L"-së: Faleminderit zoti Celibashi! Ashtu siç e thashë dhe në fjalën hapëse timen, dua të saktësoj pranë këtij institucioni që unë nuk ushtroj as profesionin e aktorit dhe as të regjisorit në Republikën e Shqipërisë. Unë jam jurist i kontraktuar dhe avokat i kontraktuar nga subjekte politike, të cilave u mbroj interesat e ligjshme të tyre lidhur me këtë institucion. Përsa i përket pjesës së mbrojtjes së interesave të tyre flas edhe për Koalicionin "Shtëpia e Lirisë", por dhe më parë për Lëvizja Socialiste për Integrim, të paktën pretendoj dhe tentoj që në respektim të këtij institucioni që na mirëpret të sillem objektivisht dhe profesionalisht me këtë institucion. Përsa i përket pjesës së aktit, zoti Celibashi jemi dakord me përmbajtjen e tij, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, meqenëse të gjitha palët keni dakordësinë mbi projektaktin e paraqitur, e miratojmë atë sipas propozimit të administratës. Për informacion atëherë, përbërja e grupeve të numërimit për këto zgjedhje do të jetë: dy anëtarë të grupeve të numërimit, do të propozohen nga Partia Socialiste; një anëtar i grupit të numërimit do të propozohet nga Partia Demokratike dhe; anëtari i katërt do të propozohet nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Mirë, faleminderit!

Vendimi nr. 77

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



14.02.2022
Ora 17:23

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Y. Merkaj, E. Meta, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

Z. I. Celibashi: Kemi çështje të tjera? Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Në fakt siç është e njohur tashmë, në datën 2 shkurt 2022 Partia Demokratike ka parashtruar një denoncim që ka pasur të bëjë me miratimin e disa listave nga ana e Bashkisë Durrës, të 526 familjeve që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit. Duke ju falenderuar sigurisht që në datën 3 shkurt 2022, me shkresën nr. protokolli 502 është kërkuar informacion nga ana e Bashkisë Durrës. Informacion ky që duhet të vihej në dispozicion brenda një afati 3 ditor. Sot nëpërmjet një shkrese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që mban datën 14.02.2022, me numër protokolli 502/2 jemi njohur me informacionin e përcjellë zyrtarisht në datën 14 shkurt 2022 nga ana e Bashkisë Durrës. Nga informacioni që na është përcjellë rezulton që denoncimi në fakt që është bërë nga ana e Partisë Demokratike rezulton i saktë. Pra, në datën 28 janar 2022 Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës ka miratuar një shtesë në listën e familjeve që përfitojnë fondet e rindërtimit, pra një listë prej 526 familjesh. Duke qenë se procedura ose hetimi administrativ siç shprehemi edhe në shkresën e Komisionit

*Zbardhi materialin audio
Mërita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

Qendror të Zgjedhjeve do të vijojë edhe më tej, ne kërkojmë nga ana juaj që në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, të kërkohet zyrtarisht nga Bashkia Durrës, që t'i vihet në dispozicion Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për efekt të hetimit, njoftimi i Sekretariatit të Këshillit Bashkiak për zhvillimin e kësaj mbledhjeje. Të gjitha projektaktet që u janë vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit Bashkiak, procesverbali i mbledhjes së datës 28 janar dhe të gjitha vendimmarrjet, të cilat janë cituar në fakt edhe në lidhjen 1 të kësaj shkrese, përkatësisht vendimet nr. 2, 4, 6, 11 dhe 12 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Durrës. Kjo me qëllim, në mënyrë që të kemi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në dispozicion dhe më pas të vijohet me procedurat siç parashikon Kodi Zgjedhor dhe akti nënligjor i dalë në zbatim të tij për rastin në fjalë. Nga ana tjetër zoti Komisioner, do kërkonim që në kuadër të këtij hetimi, të kërkohej edhe nga ana e Bashkisë Durrës, por në qoftë se Bashkia Durrës nuk e disponon këtë informacion, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, që përveç listës me 526 familje, të cilat janë përfshirë në listën e përfituesve të fondeve të rindërtimit, të na vihet në dispozicion dhe informacioni, sepse këta personat sigurisht janë kryefamiljarë, në këto familje sa është numri i atyre që janë mbi moshën 18 vjeç, pra që potencialisht kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet e 6 Marsit 2022. Kjo sepse sigurisht ka një dyshim të arsyeshëm që kjo vendimmarrje, këto procedura që vijnë në prag të zgjedhjeve të 6 marsit, nuk bëhen për qëllime të cilat do të ishin të mirëpritura në qoftë se do kryheshin në një kohë më të shpejtë dhe më të shkurtër, për të ndihmuar familje që janë prekur nga procesi i rindërtimit, por bëhen për efekt të zgjedhjeve apo të fushatës zgjedhore të 6 marsit. Kështu që do të kërkonim nga ana juaj që brenda një afati sa më të shpejtë, duke pasur parasysh edhe afatet që kanë këto zgjedhje, të kërkohet ky informacion dhe të vihet në dispozicion edhe të subjekteve zgjedhore. Duke i kujtuar sigurisht Bashkisë Durrës detyrimin që informacioni mos

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

të kërkohet brenda 3 ditëve nga data 3 deri në datën 6 dhe të vijë deri në datën 14, por të vihet në dispozicion në një afat më të shpejtë duke qenë se kemi të bëjmë me një informacion që disponohet nga Bashkia Durrës, pra nuk kërkohen, po themi procedura të zgjeruara për të siguruar këtë informacion. Kjo ishte çështja e parë. Çështja e dytë, i nderuar është se sot nga ana e strukturave të Partisë Demokratike pranë Bashkisë Rrogozhinë ne jemi vënë në dispozicion të një listë me 29 persona të cilët janë punësuar në datën 25 janar 2022, punësim sezonal për një periudhë 3 mujore. Ne vlerësojmë që edhe këto punësime të cilat janë kryer pas dekretit të datës 20 janar, të Presidentit të Republikës, për caktimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, kryhen me qëllime të posaçme elektorale në funksion të manipulimit apo të ndikimit të vullnetit të zgjedhësit në zgjedhjet e 6 marsit. Kështu që kërkojmë nga ana juaj që në vijim edhe të praktikës që është ndjekur lidhur me denoncimin tonë për Bashkinë Durrës, të kryhet një verifikim duke i kërkuar informacion në qoftë se është e vërtetë që në datën 25 janar 2022 e në vijim janë punësuar 29 persona në Bashkinë Rrogozhinë me punësim sezonal për një periudhë 3 mujore? Cilat kanë qenë arsyet e këtij punësimi? Të na vihen në dispozicion të gjitha aktet përkatëse që justifikojnë apo arsyetojnë këto akte apo këto vendime të marra nga ana e Bashkisë Rrogozhinë. Kam dhe një çështje tjetër, por t'i ndajmë nga njëra-tjetra sepse janë çështje, po themi që kanë të bëjnë me diçka tjetër.

Z. I. Celibashi: Po, mund të vazhdojmë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në rregull! Siç e dini zoti Komisioner, në datën 22 janar 2022 Komisioni Rregullator ka marrë vendimin nr. 2, datë 22 janar 2022 “Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.02.2022*

Z. Y. Merkaj: E kemi! Sepse të 6 bashkitë kanë deklaruar.

Z. I. Celibashi: Të gjashta bashkitë kanë sjellë?

Z. Y. Merkaj: Kanë sjellë afishimin ku ndodhet vendimi

Z. I. Celibashi: Kanë sjellë vendimin se ku janë vendet që do të afishohen.

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë ia japim përfaqësuesit të Partisë Demokratike, por dhe përfaqësuesit të koalicionit.

Z. Y. Merkaj: Për sa i takon pikës së parë, i kemi bërë një kërkesë sot Bashkisë Durrës, ku kemi kërkuar informacion për kërkesën e Partisë Demokratike.

Z. I. Celibashi: I paskemi dhe në faqen e internetit.

Z. Y. Merkaj: Po, informacioni mund të jetë më i detajuar, kërkesa që do t'i bëjmë për..

Z. I. Celibashi: Një raport, një informacion për të gjithë përfaqësuesit e partive politike? Dakord! Mirë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

